



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
SPORTIT DHE RINISË  
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

---

## NJOFTIM

---

Në zbatim të Rregullores së Maturës Shtetërore 2021, të gjithë maturantët/kandidatët që do të japin provimet e MSH 2021, sesioni i parë, kanë të drejtë të kërkojnë fotokopjen e testit dhe të fletëpërgjigjes, pas përfundimit të të gjitha provimeve.

Çdo maturant/kandidat që kërkon kopjen e testit dhe fletëpërgjigjes përkatëse, duhet të kryejë aplikimin online në portalin e-albania, duke përdorur shërbimin “**Kërkesë për kopje të testit të Maturës**”, duke filluar nga data **28 qershor deri më 02 korrik 2021**, për provimin e lëndës **matematikë**.

Pas trajtimit të kërkesës, QSHA do të nisë kopjen e testit dhe të fletëpërgjigjes për secilin maturant/kandidat që e ka kërkuar atë, në “Hapësira ime”, seksioni “Dokumentet e mia”, në llogarinë përkatëse të çdo maturanti/kandidati, në e-albania.

**Ky shërbim ofrohet nga QSHA pa pagesë.**